

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

GJEKAJ 2018 sh.p.k.

### NENI 1

#### THEMELIMI I SHOQERISE DHE BAZA LIGJORE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar GJEKAJ 2018 sh.p.k. eshte themeluar duke u bazuar ne ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe ligjit nr. 9723 datë. 03.05.2007 "Për qëndrën kombëtare të regjistrimit" dhe ne perputhje me te, me ortake te shoqerise 1-Paulin Gjekaj me karte identiteti G21109029G. Sot me dt 01.02.2018

### NENI 2

#### EMERTIMI

Emertimi i kesaj shoqerie do te jete GJEKAJ 2018 sh.p.k.  
Inicialet e Shoqërisë do të jenë GJEKAJ 2018 Sh.p.k.

### NENI 3

#### ADRESA E SELISE SE SHOQERISE dhe SHTRIRJA E AKTIVITETIT

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën Kamicë :Rruga Kamicë, godine 1 kateshe, nr pasurie 288, zona kadastrale 2068

Shoqeria shtrin aktivitetin e saj brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise duke gezuar te drejten qe te ngre filiale apo zyra perfaqesimi edhe ne rrethe te tjera te Republikes se Shqiperise apo dhe jashte Republikes se Shqiperise.

### NENI 4

#### KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete pa afat te percaktuar.

### NENI 5

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte :

- Sherbimi i ruajtjes dhe i sigurise fizike te objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizik e juridik qe ushtrojne veprimtarine ne Republiken e Shqiperise;sigurimin dhe mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te personave fizike ,shtetas shqiptare ose te huaj, importimin, tregtimin, transportimin e mallrave dhe instalimin e mjeteve te sistemit vrojtues,sinjalizues,audioviziv,mjeteve te mbrojtjes kundra zjarrit, paisjeve te nderlidhjes te teknikave te tjera te lejuara nga legjislacioni si dhe projektimin, instalimin dhe programimin e paisjeve te telekomunikacionit, radio komunikacionit dhe sistemeve te kontrollit dhe monitorimit ne distance te automjeteve si dhe tregtimin dhe instalimin e mjeteve te mbrojtjes kundra zjarrit.



## **KAPITALI**

- Kapitali themelor i shoqerise eshte 4.000.000 (katermilion) leke, te barazulefshme me 1 kuote.
- Në momentin e krijimit të Shoqërisë kapitali fillestar është i ndarë si më poshtë i përcaktuar;
  1. Paulin Gjekaj 100%

## **NENI 7**

### **TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT, FORMAT**

Ne rast transferimi te kuotave te kapitalit, me vendim asambleje te ortakeve duhet percaktuar çmimi ishites se kuotave qe kerkohet te transferohen nepermjet shitjes. Çmimi i shitjes duhet te vendoset ne baze te vleres reale te tyre ne momentin e dhenies se te drejtes dhe miratimit te saj nga ana e asamblese se ortakeve.

Kontrata per transferimin e pjeseve te kapitalit duhet te jete ne formen e aktit noterial, dhe ne rast se pronari i ri nuk eshte ortak i shoqerise, duhet te deklarohet shprehimisht ne kontrate se eshte njohur me aktin e themelimit te shoqerise, statutin e shoqerise dhe se eshte plotesisht dakort me to. Kjo kontrate depozitohet ne seline e shoqerise.

## **Neni 8**

### **TRANSFERIMI TEK PJESTARI I FAMILJES**

Pjeset e kapitalit jane lehtesisht te transferueshme tek familjaret, bashkeshortet, prinderit dhe femijet.

Nese nje ortak vdes, trashigimtari apo trashigimtarete ne rastin e bashkezoterimit te kuotave dhe trashigimtarete e tij ne rast se ky person ishte zoterues i vetem i bashkezoteruesve te kuotave, do te jene personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues i te drejtave mbi kuoten e tij. Pamvarsisht parashikimeve te bera ne kete STATUT, pasuria e ortakut te vetem nuk çlirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me personat e tjere.

Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si vdekjes ose falimentimit tenje ortakut, pas paraqitjes se provave te kerkuara nga administratorete, mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkoje rregjistrimin e kuotes ne emer tenje personi tjetet te caktuar prej tij si perfitues i kuotes.

Personi qe fiton te drejtat mbi nje kuote si pasoje e vdekjes ose falimentimit te ortakut do te kete drejtat qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drjten e votes ne asamble deri ne momentin e rregjistrimit ne QKR.

## **NENI 9**

### **RRITJA DHE REDUKTIMI I KAPITALIT THEMELOR**

- Kapitali themelor i shoqerise mund te rritet apo reduktohet pa kufizim ne çdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- Ortakunukështë I  
detyruartarrisëvlerënektributittëvetmbishumën,përtëcilën



- është rënë dakord, osetashtojë atë, nëse ky kontribut është zvogëluar ngahumbjet.
- Ortakun nuk mund ta zvogëlojë vlerën e kontributit të vet, pamirë timine ortakëve të tjerë
  - Asambleja mund të vendos reduktimin e kapitalit të shoqërisë brenda limiteve ligjore.

## **NENI 10 ORGANET E SHOQËRISË DHE PERFAQESIMI**

- Asambleja e ortakeve
- Administratori

## **NENI 11 ASAMBLEJA**

Organi vendimor i shoqërisë është asambleja e ortakeve.

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, ngaligjet të tjera ose nga dispozitatë statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret për të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori për të ortakët.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultoni se ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë të rreptshme, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultoni në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të parapara për regjistrimin e saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultoni në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa kufizime, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të sigurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe bulimitit të humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e para regjistruar në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria

nuk mund të kundërshtojë pavlefshmërinë e tyre, që kafi tuartë drejtanë mirëbesim, përveç rastit

kur shoqëria aprovon se i tretit ka pasur dijeninë për pavlefshmërinë, aponë bazë të rrethana vetë qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeninë për të.

## **NENI 12 KOMPETENCAT E ASAMBLESE**

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet më poshtme:
2. Asambleja e përgjithshme merr vendimin që për kryerjen e të gjitha veprimeve financiare, ekonomike, tregtare, si për firmosjen e faturave të blerjes dhe të



- shitjes, te veprimeve ekonomike ne banke per firmosjen e te gjitha transfertavete kryera nepermjet bankave, te kryhen njekohesisht nga te dy bashkpronaret .
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pikë;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet tjetra ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështjet tjetra të parashikuara nga ligji i poststatuti.

### **NENI 13 TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE**

- Ortaku ka të drejte të jete i informuar ne lidhje me administrimin e shoqerise, te njihet me bilancin vjetor dhe te kerkoje sqarime me shkim nga administratori.
- Ortaku gjithashtu ka te gjitha ato te drejta dhe detyrime te tjera qe percaktohen ne dispozitat ligjore e konkretisht ligji 9901 “Per tregtare dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar.
- Ortaku ka te drejttat e barabarta me administratorin , te kryeje te gjitha veprimet si bankare ashtu edhe ligjore .

### **NENI 14 ADMINISTRATORI**

Administratori i shoqerise eshte Paulin Gjekaj dhe ka kopetenca te plota ne te gjitha vendimmarrjet.

### **NENI 15 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Kompetencat kryesore të Administratorit janë:

- kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë së shoqërisë, duke zbatuar politikat e përcaktuara nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqëson shoqërinë
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve, të regjistrave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet këto dokumente asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijon një sistem informimi dhe vlerësimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



- kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- Raporton në Asamble sipas kërkesave të asamblesë së anëtarëve;
- Ka çdo lloj kompetence tjetër të parashikuar në ligj me përjashtim të atyre kompetencave që sipas ligjit janë atribut të Asamblesë.

Administratorit, të cilit i ka mbaruar mandati i plotë i emërimit, kryen vetëm ato detyra, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e shoqërisë, deri në emërimin e administratorit të ri.

#### **NENI 16**

#### **AKTIVITETI USHTRIMOR VJETOR, BILANCI DHE NDARJA E FITIMIT**

- Viti ushtrimor i aktivitetit të shoqërisë mbyllet me çdo datë 31 Dhjetor.
- Në përfundim të vitit ushtrimor, administratori procedon me hartimin e bilancit, llogaritjen e fitimit dhe të humbjes sipas ligjit
- Pas plotësimit të detyrimeve ligjore nën 77 të ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të asamblesë së përgjithshme, mund të deklarojë shpërndarjen e dividendit.
- Shpërndarja e fitimit do të kryhet në mënyrë të tillë :
  - a. 100% e fitimit do të shpërndahet në proporcion me kontributin e secilit prej ortakëve.
  - b. Në të njëjtin raport do të shpërndahen edhe shpenzimet.

#### **NENI 17**

#### **SHKRIRJA E SHOQËRISE**

Shoqëria shkrihet dhe hyn në proces likuidimi për shkaqet e mëposhtme:

1. Përfundimi i afatit të shoqërisë, sipas përcaktimeve të statutit;
2. Vullneti i anëtarëve, i manifestuar nëpërmjet vendimit të asamblesë së përgjithshme;
3. Përmbushja e plotë e objektit të shoqërisë ose pamundësia për ta përmbushur atë;
4. Zvogëlimi i numrit të anëtarëve nën minimumin ligjor të nevojshëm, për të krijuar një shoqëri, sipas dispozitave të ligjit, nëse numri i nevojshëm i anëtarëve nuk rivendoset brenda një periudhe prej 6 muajsh;
5. Bllokimi i veprimtarisë vendimmarrëse të ndonjërit prej organeve të shoqërisë ose mosushtimi i veprimtarisë së shoqërisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare;
6. Reduktimi i kapitalit të shoqërisë nën minimumin e përcaktuar në ligj, nëse nuk rivendoset brenda një periudhe gjashtëmuajore;
7. Nisja e procedurave të falimentimit;
8. Mosushtimi i veprimtarisë për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçare dhe mosnjohja e pezullimit të veprimtarisë, në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
9. Nëse shoqëria rezulton me humbje për një periudhë të vazhdueshme 5-vjeçareme vendim të gjykatës;
10. Për çdo arsye tjetër, të përcaktuar në ligj.



**NENI 18**  
**LIKUIDIMI**

1. Përveç rasteve kur kundrejt shoqërisë është hapur një procedure falimentimi ndaj personit juridik, sipas dispozitave të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, verifi kimi i një prej shkaqeve të përmendura në nenin 15 të këtij Statuti, ka si pasojë hapjen e fazës së likuidimit të shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese.
2. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas vendimit të prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë t’i kërkojë gjykatës zëvendësimin e likuiduesit, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cënohet nga likuiduesit e emëruar si më sipër.
5. Likuiduesi emërohet nga gjykata në rastet kur shoqëria prishet me vendim të gjykatës.

**NENI 19**  
**DISPOZITAT E FUNDIT**

Persa nuk është shprehur në kete statut është kompetence e Asamblese se Ortakeve. Ky statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ditë në të cilën shoqëria njihet edhe si person juridik.

**ORTAKUI SHOQERISE**

**1. Paulin Gjekaj**

